



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 51 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 29/ 04 / 2024

VENDIM

Nr.10, datë 29 /04/2024

PËR

PLANIN E GADISHMËRISË PËR EMERGJENCAT CIVILE TË DIGËS SË HEC OSOJA

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 29.04.2024 mori në shqyrtim Raportin Vjetor dhe Planin e Gadishmërisë për emergjencat civile të digës së HEC Osoje paraqitur nga Shoqëria Favina shpk.

Dokumentacioni i Planit të Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë kërkesat e udhëzimit të KKDM në lidhje me hartimin e këtyre planeve të shprehura në Vendimin e KKDM Nr.5, datë.16.11.2020. KTPD i rekomandoi antarëve të KKDM të miratoj Planin e Gaidshmërisë në rastet e emergjencave civile të digës së HEC Osoja. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Planin e Gaidshmërisë në rastet e emergjencave civile të digës së HEC OSOJA të paraqitur nga Shoqëria FAVINA shpk.
- 2- Ti kërkoj shoqërisë FAVINA shpk:
 - Instalimin e sistemeve të monitorimit Hidrometeorologjik, gjeodezik, sizmik dhe hidrogeologjik në trupin e digës dhe dërgimin pranë KKDM të skemave dhe planimetrive të vendosjes së sistemeve të monuitorimit të digës
 - Përditësimin e rregullores së shkarkimit të plotave të mëdha duke përfshirë edhe shkarkimet për shkak të prurjeve të mëdha që vijnë në herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI